

Syllabus i lëndës

Lënda: **AKAID IV, Studim krahasimtar i feve**

Programi i studimit: **Teologji**

Numri i ECTS kredive: **6 ECTS Kredi**

Niveli dhe lloji i lëndës: **Obligative**

Kodi i lëndës: **402**

Fondi i orëve: **2+2**

Profesori: **Prof. ass. dr. Zija Abdullahu**. Kontakti: e-maili: **zabdullai@hotmail.com**

Qëllimi i lëndës

Pajisja e studentëve me njohuri bazë nga lëmi i Akadit IV, Studim i krahasimit të feve, duke hulumtuar dhe studiuar fetë më të rëndësishme dhe më me shtrirje më të gjerë në botë. Zhvillimi i shkathtësive dhe aftësive për të analizuar të dhënat e feve të ndryshme të cilat i përfshinë programi studimor në mënyrë që të mund të nxjerrin konkluzione për to. Fitimi dhe avancimi i sensit të kritikës në aspektin e vlerësimit të argumenteve bazuar në fakte përkatëse të feve. Aftësimi për të shkruar ese apo për të diskutuar për to, në një stil të pastër dhe bindës të të shprehurit me gojë dhe me shkrim, tipare këto të një personi me një edukim liberal akademik. Prej leksioneve nga Krahasimi i feve presim që studenti pas përfundimit të këtij kursi të përfitojë kulturë të përgjithshme për fetë më dominuese në arenën ndërkombëtare, siç janë fetë e shpikur, e po ashtu edhe ato në esencë që ishin të shpallura, si Hebraizmin, dhe Krishterimi fe me të cilat bashkëjetojmë në trevat tona dhe që kemi shumë gjëra të përbashkëta. Të kuptojë studenti proceset e zhvillimit që nga formimi i tyre e deri në ditët e sotme. T'i jepet mundësi studentit që në formë kritike duke nxitë debate, t'i kuptoj se çështjet e përbashkëta që i afrojnë fetë mes veti janë shumë më shumë se ato që i ndajnë. Të kuptojë se zhvillimi i Krahasimit të feve ka një trend pozitiv të ngritjes së tolerancës në shoqëri, dhe se Krahasimi i feve duhet të zhvillohet dhe të avancohet ditë e më shumë, mbase është në interes të bashkëjetesës dhe të paqes në rajon dhe në botë

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:

Të përshkruaj etapat e zhvillimit të feve më dominuese në botë.

Të krahasoj ndërmjet feve të ndryshme të cilat i studion gjatë kursit.

Të diskutoj rreth këtyre feve në bazë të argumenteve të secilës fe, duke qenë sa më objektiv në parashtrimin e tyre.

Të mbroj qëndrimet e secilës fe, ashtu siç i konceptojnë ithtarët e tyre.

Të prezantoj mendimin kritik ndaj secilës prej tyre, duke paraqitur atë më të vlefshmin.

Të jetë në gjendje që njohuritë e fituara t'i aplikoj në relacionet ndërkonfesionale.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave, stimulimit të studentëve në diskutime interaktive, duke bërë pyetje dhe analiza në kuadër të ligjëratës së mbajtur. Po ashtu do të mbahen seminare dhe ese të ndryshme, të cilat do të prezantohen në mënyrë individuale por edhe grupore, dhe teste të vetëvlerësimit. Gjithashtu studentët kanë mundësi që gjatë përgatitjes së lëndës të kontaktojnë me profesorin dhe të marrin udhëzime me qëllim të arritjes së cilësisë dhe rezultateve në mësim dhe sukses të studentëve.

Përmbajtja e lëndës:

Java e pare: *HYRJE*, njohja me syllabusin, metoda, organizimi, kërkesat dhe vlerësimi. Shqyrtime të përgjithshme: *FEJA SI FENOMEN MBARËNJERËZORË*. Dallimi ndërmjet filozofive dhe feve të sajara. Frytet e besimit në fe. Kontributi i muslimanëve në studimet krahasimtare të feve dhe metodologjia e tyre. Studimi krahasimtar i feve të shqiptarët. Frytet e shkencës së krahasimit të feve.

Literatura: Dr. Zija Abdullahu, *Studim krahasimtar i feve*, f. 11-42. (Në vazhdim do të jetë kjo literaturë bazë, andaj do të mjaftohemi vetëm me cekjen e faqeve).

Java e dyte: *HYRJE* në pjesën e parë të Studimit, gjegjësisht në fetë të sajara. *FEJA NË PERSINË E LASHTË-ZOROASTRIZMI*; 1- Jeta dhe vepra e Zoroastrit. 2- Besimet;. 3-Adhurimi i zjarrit. 4-Libri i shenjtë. 5- Sektet. *FETË MË TË RËNDËSISHME NË INDI*; *HINDUIZMI*: 1- Besimet. 2-Adhurimet. 3-*Ahimsa*, 4-Libri. 5-Kremtet dhe zakonet fetare. Bisedë interaktive, për krahasimin e moralit hindus me atë islame. Propozimi i temave për punime seminarike dhe për ese.

Literatura: (f. 43-78)

Java e trete: *BUDIZMI*: 1-Zanafilla; Ndriçimi (Nirvana) 2-Besimet. 3-Adhurimet. 4-Librat. 5- Qëndrimi i Budës ndaj; pasurisë, punës dhe gruas. *XHAINIZMI*: 1- Zanafilla. 2- Doktrina. 3-Besimet. 4-Adhurimet. 5-Libra. 6-Doktrina dhe mësimet etike. 8- Fraksionet. 9-Xhainizmi sot. *SIKIZMI*: 1-Zanafilla; 2- Besimet. 3-Libri i shenjtë. 4- Rituale të adhurimit. 5-Rregullat tjera fetare. 6-Ceremonitë. 7-Fraksionet. 8-

Zhvillimi i historik i identitetit të sikëve. 9-Sikizmi sot. Leximi i punimeve seminarike dhe eseve dhe diskutimi rreth tyre.

Literatura: (f. 79-123)

Java e katert: FETË MË TË RËNDËSISHME NË KINË. Taoizmi dhe Konfuçizmi. **TAOIZMI:** 1-Zanafilla. 2-Nga filozofia në fe. 3-Besimet. 4-Librat. 5-Ritualet fetare. 6-Kalimi në idhujtari. 7-Taoizmi sot. **KONFUÇIZMI:** 1-Zanafilla. 2-Doktrina. 3-Besimet. 4-Librat. 5-Sektet. 6-Dallimi me fetë tjera. 7-Konfuçizmi sot. **FEJA MË E RËNDËSISHME JAPONI: SHINTOIZMI:** 1-Zanafilla. 2-Depërtimi i Budizmit dhe Konfuçizmit. 3-Besimet. 4-Tempujt dhe ritualet. 5-Librat. 6-Festat. 7-Sektet. 8- 9-Periudhat e Shintoizmit. 10-Shintoizmi sot. Bisedë interaktive, rreth shndërrimit të filozofisë në fe.

Literatura: (f. 125-164)

Java e peste: Hyrje në pjesën e dytë, Hebraizmi dhe Krishterimi. **HEBRAIZMI (JAHUDIZMI). HISTORIA E HEBRAIZMIT:** Pasqyrë historike e Hebraizmit nga zanafilla e deri te formimi i shtetit kombëtarë Izraelit. **LIBRAT E SHENJTË TË HEBRAIZMIT:** 1- Dhiata e Vjetër, Tora\Tanah\Tevrati. 3-Ndarja e saj te të krishterët. 4-Përmbajtja e librave apokrifë. 5-Besueshmëria. 6-Qëndrimi islam ndaj librave të shenjtë të tyre. 7-Talmudi dhe pjesët e tij. **BESIMET HEBRAIKE:** Koncepti i besimit në Zot, pejgamber ringjallje, në Mesiun e premtuar, dhe Mesiun në tekstet islame. Bisedë interaktive, rreth Torës, Talmudit, Kur'anit dhe Mesiut.

Literatura: (f. 169-284)

Java e gjashte: JETA FETARE NË JAHUDIZËM: 1-Përkufizimi i identitetit Jahudit. 2-Rregullat e adhurimeve;. 3-Festat, dhe simbolet 3-Jeta familjare.; synetimi, *Bar Micva*, varrimi, kutia rikujtuese, ushqimet, kamata. **SEKTET NË JAHUDIZËM:** 1-Samarenjtë. 2-Farisenjtë, 3-Saducenjtë. 4-Zelotët. 5-Karaitët. 6-Misticizmi jahudit. 7-Hasidizmi dhe misticizmi islam. 8-Jahudizmi në diasporë; Ashkenazët, Sefardët. **Testi i parë**

Literatura: (f. 285-322).

Java e shtatë: HYRJE NË VAZHDIM TË PJESËS SË DYTË. NË PASQYRË E HISTORIKE E KRISHTERIMIT NË KURAN. Jeta e Isait a.s.,pejgamberia si dhe muxhizet/mrekullit në Kuran. **JEZUSI NË KRISHTERIM.** Jeta e Jezusit. Apostujt. Pse vdiq Zoti- Jezu Krisht. Krishterimi pas Jezusit. Krishterimi dhe përndjekjet. Propozimi i temave për punime seminarike dhe për ese.

Literatura: (f. 325-360).

Java e tetë: PËRÇARJET KRISHTERE. Sauli\Pali. Armiqësia e tij me më të afërmit e mëparshëm. Pali pranon shpallje dhe bën mrekulli. Pali dhe Hebraizmi. Risitë që sollti Pali në Krishterim. **LIBRAT E SHENJTË TË KRISHTERA.** Dhiata e Re dhe librat e saj. Ungjilli sipas Mateut, Markut, Llukës dhe Gjonit. Veprat e Apostujve. Letrat e apostullit Pal.

Letrat katolike, apo letrat krishtere. Bisedë interaktive, rreth dallimeve të ungjijve dhe letrave apostolike

Literatura: (f. 376-398).

Java e nëntë: *UNGIJITË APOKRIFË*. Ungjilli i ebionitëve, hebraik, i Barnabës, i Jakobit, Tomasit, dhe Pjetrit. Shqyrtim kritik ndaj Librave të Shenjtë. Kur'ani famëlartë- shpallje e Zotit. *BESIMET KRISHTERE*. Trinia e Shenjtë. Pikëpamjet islame mbi Trinitetin dhe elementet e tij. Leximi i punimeve seminarike dhe eseve dhe diskutimi rreth tyre.

Literatura: (f. 400-433).

Java e dhjete: *ORIGJINA E TRINITETIT*. Pozita e Marisë në Krishterim. Mëkati i parë dhe trashëgimia e tij. Drejtësia e Zotit. Shlyerja e mëkatit me besimin në gjakderdhje. *KRYQËZIMI I JEZUSIT*. Ngjarja e kryqëzimit. Të dhënat kontradiktore të ungjijve. Koncepti Islam i kryqëzimit. Jezusi gjykatës në jetën e asaj bote. Besimi në Ditën e Ringjalljes. Bisedë interaktive rreth rrëfimit të kryqëzimit të muslimanët dhe të krishterët.

Literatura: (f. 434-465).

Java e njëmbëdhjete: *JETA FETARE NË KRISHTERIM*. Misteret e Kishës-sakramentet: Pagëzimi, kungimi, pengimi, mirosja, misteri i priftërinjve, martesat, dhe vajimi. *ADHURIMET*. Lutjet drejtuar Zotit-Jezus. Kryqëzimi. Agjërimi. E dhjeta. Pelegrinazhi. Debat rreth pelegrinazhit të krishterë dhe haxhillëkut islam.

Literatura: (f. 467-483).

Java e dymbëdhjetë: *FESTAT KRISHTERE*. Krishtlindjet-Kërshëndellat. Periudha e Pashkëve. Festimi i ditës së diel. Bisedë interaktive, rreth periudhës së Pashkëve dhe Ashurës të Muslimanët. *KËSHILLAT-KONCILET EKUMENIK*. Koncili i Nikesë (325). Koncili i parë i Konstantinopojës (381). Koncili i parë i Efesit (431). Koncili i Halkedonit (451). Koncili i katërt i Konstantinopojës (869). Koncili i dytë i Vatikanit (1962-65). Diskutime rreth leksioneve nga orët e mëparshme.

Literatura: (f. 484-496)

Java e trembëdhjetë: *SEKTETE FETARE KRISHTERE. NDARJA FILLESTARE*. Ebionitët\Hebraiko-krishterët. Docetizmi. Monarshizmi. Arianizmi. Monofizitizmi. Diofizitizmi. Leximi i punimeve seminarike dhe eseve dhe diskutime rreth leksioneve nga orët e mëparshme. *NDARJA E MADHE E KISHËS*. Ortodoksizmi. Katolicizmi. Protestanizmi. Rëndësia e Kishës në Krishterim. Kisha dhe pjesët e saj. Hierarkia e Kishës.

Testi, studentët do të ndahen në dy grupe për mbajtjen e testit përfundimtar.

Literatura: (f. 500-554).

Kriteret dhe komponentët e vlerësimit:

Prezantimi dhe aktiviteti gjatë orës: **10 pikë**

Punimi seminarik: **10 pikë**

Vlerësimi i testit të parë: **20 pikë**

Vlerësimi i testit të dytë: **20 pikë**

Provimi final: **40 pike**

Standardi i notimit në FSI:

10= 90% - 100%. SHKËLQYESHËM- njohuri të shkëlq. me vetëm disa gabime minore.

9= 81 – 89. SHUMË MIRË – mbi mesatare standarde, por me disa gabime.

8=71 – 80. MIRË – rezultat në përgjithësi i mire me disa gabime që vërehen.

7=61 – 70. KËNAQSHËM – mire,por me mjaft gabime.

6=51 – 60. MJAFTON – rezultatet plotësojnë kriteret minimale.

5=0 – 50. DOBËT – kërkohet shumë punë për të fituar kredi.

Literatura themelore:

Dr. Zija Abdullahu, *Studim krahasimtar i feve*, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë, 2010.

Literatura plotësuese:

1. *Kurani*; përkthim dhe komentim, përktheu: H. Sherif Ahmeti. Medinë, 1992.
2. *Bibla: Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e Re* (Bibla katolike), përktheu: Don Simon Filipaj, Ferizaj, 1994.
3. *Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re* (Bibla protestante), përktheu: ?, Tiranë, 1999.
4. *Shkrimet e Shenjta* (Bibla e Dëshmitarëve të Jehovait), përktheu: ?, New York, 2005.
5. Abazi, Dedë, *Si na është zbuluar Zoti*, Prishtinë, 2008.
6. Alderson, dr. Richard, *Të krishterët e hershëm*, Prishtinë, 2002.
7. Bocaille, dr. Maurice, *Bibla, Kurani dhe shkenca*, Gjakovë, 1997.
8. el-Havli, dr. Muhammed Ali, *Komparacioni mes katër ungjijve*, Shkup, 2002.
9. Enciklopedia elektronike britanike “*Encyclopaedia Britannica 2011 – Ultimate Reference Suite*” .
10. Farago, France, *Kishterimi, Judaizmi, Islami dhe mendimi perëndimor*, Tiranë, 2007.
11. Karabell, Zachary, *Ithtarët e librit*, përkth. nga angl. Fuad Morina, bot. Koha, Prishtinë.
12. Gyndyz, dr. Shenasi, *Dhuna fetare*, Prishtinë, 2005.
13. Murtezai, dr. Ekrem, *Fjalor i feve*, 2000.
14. Nesimi, mr. Qani, *Ortodoksizmi te shqiptarët*, Tetovë, 2005.

15. Penner, Hans, *Buda, Budizmi*, përkth. Azra Kraja, bot. "Helga's Secrets, Tiranë
16. Sarikçioğlu, dr. Ekrem, *Historia e feve, prej fillimit deri më sot*, Shkup, 2007.
17. Solejmani, Abdurrahim, *Fetë e gjalla të botës*, bot. Përkth. nga boshnj. Ukshin M. Musliu "Ibni Sina", Prishtinë, 2015.
18. Shtot, Xhon, *Bazat e Krishterimit*, Tiranë, 1997.
19. Topaloglu, dr. Bekir, *Bazat e besimit Islam*, Prishtinë, 2002.
20. Tuçi, Gjuzepe, *Historia e filozofia indiane*, Prishtinë, 1989.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti është i obliguar për vijimin e rregullt të ligjëratave dhe ushtrimeve (mbahet evidenca për studentët e rregullt). Të gjithë studentët janë të obliguar t'i përfillin rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë gjatë mësimin, ç'kyçja e telefonave celular, dhe hyrja me kohë në sallë.

Konsultimet:

Orët e konsultimeve mbahen në kabinet sipas orarit të dhënë dhe mund të shfrytëzohet për ndihmë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me lëndën.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë\Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	14	28
Ushtrime teorike	1	14	14
Punë praktike	-	-	-
Kontaktime me mësimdhënësin\konsultime	1	14	14
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume, seminare, ese	2	2	4
Detyra të shtëpisë	-	-	-

Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	14	28
Përgatitja përfundimtare për provim.	4	2	40
Koha e kaluar në vlerësim (teste, ese, provim final)	2	8 ditë	16
Provimi	2	1	2
Totali	14	14 javë	146